

VENDIM
Nr. 48, datë 27.1.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT/RIFORCIMIT TË OBJEKTEVE NË ADMINISTRIM TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, NË BASHKITË Durrës dhe Lezhë, dhe CAKTIMIN E SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT SI NJËSI ZBATUESE

(Ndryshuar me vendimin nr. 492, datë 21.7.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit/riforcimit të objekteve në administrim të Shërbimit Informativ të Shtetit, të ndodhura në bashkitë Durrës dhe Lezhë, në masën 21 586 378 (njëzet e një milionë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) rindërtimi i objektit në administrim të Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH), të ndodhur në Bashkinë Durrës, në masën 17 402 445 (shtatëmbëdhjetë milionë e katërqind e dy mijë e katërqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH;

b) rikonstruksioni/riforcimi i objektit në administrim të Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH), të ndodhur në Bashkinë Lezhë, në masën 4 183 933 (katër milionë e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

2. Shërbimit Informativ të Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i shtohet fondi në masën 7 220 733 (shtatë milionë e dyqind e njëzet mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit/riforcimit të objekteve, sipas pikës 1 të këtij vendimi, i detajuar si më poshtë vijon:

a) në masën 5 220 733 (pesë milionë e dyqind e njëzet mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të objektit në administrim, të ndodhur në Bashkinë Durrës;

b) në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit/riforcimit të objektit, të ndodhur në Bashkinë Lezhë.

2/1. Shërbimit Informativ të Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, i shtohet fondi në masën 1 965 695 (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për rikonstruksionin/riforcimin e objektit në administrim të Shërbimit Informativ të Shtetit, të ndodhur në Bashkinë Lezhë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, të miratuar për vitin 2022.

3. Caktimin e Shërbimit Informativ të Shtetit si njësi zbatuese për rindërtimin dhe rikonstruksionin/riforcimin e objekteve, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama